

POLITIKA E PRIVATËSISË

I nderuar vizitor,

Ju bëjmë me dije se, me qëllim për t'ju ofruar një shërbim sa më të mirë, të shpejtë dhe sipas kërkesave tuaja, Banka ProCredit ka krijuar disa forma aplikimi, ku disa nga fushat e faqes së internetit të ProCredit Bank si psh. aplikimi në Programin "Bankieret e Rinj" apo kërkesa online për Aplikim për Shërbime Bankare, apo ankesat e klientëve kërkojnë nga përdoruesi që të plotësojë formën e aplikimit online duke vendosur në këtë mënyrë, edhe disa nga të dhënat e tij personale.

Të dhënat do të grumbullohen, përpunohen dhe ruhen nga banka në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele". Këto veprime do të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës privatë.

Banka ProCredit thekson se dhënia e të dhënave tuaja personale nuk është e detyrueshme dhe është në dëshirën e cdo subjekti për të dhënë vullnetarisht informacionin e kërkuar dhe për të vijuar më tej me aplikimin për qëllimin për të cilin ajo kërkohet (psh: aplikim për punë, aplikim për shërbime bankare, aplikim i ankesës online).

Në këtë kuadër, Banka ProCredit dëshiron të vërë në vëmendje të cdo përdoruesi se pasi informacioni ka mbërritur në Web serverin e Bankës, kjo e fundit implementon një sistem sigurie të standartëve më të larta për ruajtjen dhe përpunimin e mëtejshëm të këtyre të dhënave, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele". Në përdorim masat e duhura të sigurisë për të mbrojtur të dhënat nën kontrollin tonë kundër manipulimit, humbjes, shkatërrimit, aksesin e përsonele të paautorizuar dhe zbulimin e paautorizuar. Procedurat tona të sigurisë përmirësohen vazhdimisht duke vënë në funksionim teknologji të reja.

Përdoruesi konfirmon plotësimin dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë duke deklaruar se ka plotësuar në mënyrë korrekte dhe të vërtetë të gjithë informacionin e kërkuar. Gjithashtu, me plotësimin e aplikimit online, përdoruesi deklaron se jep miratimin e tij për procesimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë për përdorim nga ana e bankes sipas deklaratës së privatësisë mbi të cilin klienti jep pëlqimin e tij në rastin e aplikimit në ProCredit Entry Programme sipas linkut: <https://cv-uploader.procredit-holding.com/PrivacyPolicy/Privacy%20Statëment%20Albania.pdf>, apo për qëllimin për të cilin përdoruesi ka deklaruar vullnetarisht të dhënat e tij personale dhe/ose për njoftime promovionale me mjete të ndryshme komunikimi në rast se subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij online (rasti i aplikimeve online për shërbime bankare).

Dëshirojmë të qartësojmë të gjithë subjektet e të dhënave, se informacioni i dhënë prej jush do të përpunohet nga ana jonë sipas qëllimit të përcaktuar, apo pëlqimit të klientit, apo përcaktimeve të legjisllacionit shqiptar. Këto të dhëna nuk i transmetohen palëve të treta të paautorizuara pa pëlqimin e klientit, sipas kuartit të legjisllacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në cdo moment, pasi përdoruesi të ketë dhënë vullnetarisht informacionin e kërkuar në fushat specifike, këtij të fundit i lind e drejta që, nëpërmjet një kërkesë pranë Bankës ProCredit, të aksesojë këto të dhëna si dhe të kërkojë korrigjimin e tyre. Ruajtja, trajtimi dhe përpunimi i këtyre të dhënave bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Politika jonë e privatësisë mund të ndryshojë në të ardhmen.

Megjithatë në asnjë rast nuk do të mund të kufizohen të drejtat e garantuara nga ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Dëshirojmë t'ju informojmë paraprakisht se gjatë gjithë marrëdhënies suaj me bankën ProCredit, për arsye eficente dhe cilësie të lartë shërbimi disa shërbime mund të transferohen dhe të kryhen në kohë reale nga Banka ProCredit në Kosovë. Për realizimin e shërbimeve të ofruara nga banka kundrejt Klientit nevojitet që të dhënat tuaja personale të transferohen në kuptim të ligjit në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale" pranë Bankës ProCredit në Kosovë, shtet i cili nuk ka nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë arsye transferimi do të kryhet në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar si dhe Udhëzimin Nr. 41, Datë 13. 06. 2014 "Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave", duke synuar sigurimin e një niveli të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.